



Pranuar / Dorezuar Primijsni/Prodato Received/Delivery	20.04	2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMSTHCK	2270/2022		1/4	



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.779/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca -anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses,, sipas Aktgjykimit A.nr.2609/2021 i datës 15.03.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.779/2021 të datës 01.09.2021 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Komuna e Vitisë , në çështjen juridike „pezullim parandalues”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 20.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Shfuqizohet Vendimi i datës 17.08.2021 me nr.02-035/02-588 i Kryetarit të Komunës së Vitisë.
- II. Obligohet Kryetari i Komunës së Vitisë që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh të rishqyrtoj Vendimin e datës 17.08.2021 me nr.02-035/02-588.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi punësuar në Komunën e Vitisë, në vendimin me nr.02-035/02-588 pozitën Zyrtar i Pylltarisë në Drejtorin e Bujqësisë sipas Akt emërimit të datës 21.08.2014 me datën 17.08.2021 Kryetari i Komunës së Vitisë ka nxjerrë vendimin me nr.02-035/02-588 për pezullim sipas detyrës zyrtare me arsyetimin ndaj ankuesit është duke u zhvilluar procedurë penale PPRKR nr.149/21.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin me nr.02-035/02-588 për pezullim sipas detyrës zyrtare me arsyetimin se ndaj ankuesit është duke u zhvilluar procedurë penale PPRKR nr.149/2, me datën 01.09.2021 ka parashtruar ankesë përmes postës me numër protokollit 4462/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 06.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Vitisë . Ndërsa me datë 20.09.2021 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 15.10.2021 përmes shkresës me numër të protokollit 5049/2021, ka njoftuar ankuesin për pamundësinë e vendosjes lidhur me ankesën e tij të datës 01.09.2021, duke udhëzuar te njëjtin që ti ndjekë më tutje procedurat ligjore. Ankuesi ka parashtruar padi me datë 03.11.2021 pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative kundër heshtjes së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 15.03.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.2609/2021, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit ka anuluar Njoftimin e KPMSHCK-së të datës 15.10.2021 dhe detyron të njëjtin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e paditësit të datës 01.09.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 01.09.2021 me numër protokollit 4462/2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim për pezullim sipas detyrës zyrtare i datës 17.08.2021 me numër 02-035/02-588 i nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Vitisë; Përgjigje në ankesë e datës 20.09.2021 me numër protokollit 4691/21 bashkë me shkresat e lëndës; Akt emërimi i datës 21.08.2014 me nr.02-112/1151; Kërkesë për pushim i datës 01.06.2021; Procesverbali i seancës dëgjimore PPRKR.nr.149/2021; Aktvendimi i datës 30.03.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti Special; Njoftim i datës 06.04.2022 i avokatit; Aktgjykimin A.nr.2609/2021 i datës 15.03.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative dhe Njoftimi i datës 15.10.2021 me numër protokollit 5049/2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkëngjitura si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit ka vërtetuar se ekziston baza ligjore për të vendosur, që lënda e ankuesit të kthehet në *rishqyrtim, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se Kryetari i Komunës së Vitisë me rastin e nxjerrjes së vendimit për pezullim sipas detyrës zyrtare ka vepruar në kundërshtim me nenin 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është i mangët sepse nuk kemi asnjë

provë që argumenton vendimin për pezullim sipas detyrës zyrtare me nr.02-035/02-588 të datës 17.08,2021 të nxjerrë nga Kryetari i Komunës, ndërsa me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese kemi shqyrtuar procesverbalin e seancës dëgjimore të datës 02.07.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti i Krimeve të Rënda,Aktvendimi PPRKR.nr.149/2021,Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti Special të datës 30.03.2022 me të cilin i ndërpritet ankuesit arresti shtëpiak duke u bazuar në shkresën zyrtare të dërguar me datën 13.08.2021 nga Prokuroria Themelore në Prishtinë duke potencuar faktin se ndaj ankuesit është duke u zhvilluar procedurë penale sipas lëndës PPRKR nr.149/21.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Vitisë në këtë rast ka vepruar në kundërshtim me nenin 56 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se "1. Nëpunësi civil pezullohet, sipas detyrës zyrtare të organit përkatës të punëdhënësit, dhe nënparagrafi 1.4 ku përcaktohet se "1.4. kur gjykata vendos ndaj nëpunësit civil si masë parandaluese penale pezullimin e ushtrimit të detyrës apo shërbimit publik, sipas ligjit në fuqi", ndërsa nëse bazohemi në dispozitat potencuara më lartë respektivisht nenin 56 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë specifikishtë parashihet e drejta e gjykatës kompetente të vendosë në lidhje me pezullimin sipas detyrës zyrtare të nëpunësit civil, ndërsa nga përmbajtja e shkresës me nr.02-035/02-588 të datës 17.08,2021 të kryetarit të Komunës së Vitisë dhe referencës ligjore të nxjerrjes së këtij vendimi shihet se gabimisht ka aplikuar dispozitën materiale, nenin 56 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë sepse kjo e drejtë nuk i njihet sipas ligjit të zyrtarëve publik kryetarit të Komunës por se kjo e drejtë i përket gjykatës kompetente.

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Vitisë me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 17.08.2021 me nr.02-035/02-588 për pezullim sipas detyrës zyrtare, ka vepruar në kundërshtim me nenin 56 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse nuk ju ka referuar ndonjë vendimi gjyqësor që i ka shqiptuar masën e pezullimit parandalues përkundër që si referencë ligjore me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi e ka pikërisht këtë dispozitë që lidhet me pezullim sipas detyrës zyrtare ,së paku kolegji me rastin e trajtimit të lëndës nuk ka hasë në ndonjë vendim të Gjykatës kompetente e që këtë vendim e bënë të paqartë ,kundërthënës dhe të pakuptueshëm andaj edhe u vendosë që të kthehet në rishqyrtim vendimmarrja në lidhje me këtë rast, duke u obliguar kryetari i komunës që të ndërmer të gjitha veprimet ligjore me qëllim që të vihet ligjshmëria sa i përket kësaj çështje.

Kolegji konstaton se arsyetimi i një akti administrativ me shkrim, do të duhej të ishte i bazuar në dispozitat e nenit 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: "1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:.....2.shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi", që në rastin konkret kryetari i komunës me rastin e pezullimit sipas detyrës zyrtare ,nuk ka marrë për bazë këto dispozita, dhe se pretendimi ankimor i ankuesit në këtë çështje juridike është i bazuar, nga se në rastin konkret në bazë të provave të lëndës këto dispozita nuk janë marrë parasysht me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi.

Kolegji konstaton se me qenë se kemi të bëjmë me një çështje specifike dhe të ndjeshme por se nga administrimi i shkresave të lëndës nuk mund në asnjë mënyrë të arsyetohet baza ligjore që

kryetari i komunës të pezullojë zyrtarin publik sipas dispozitave së cilave ju ka referuar në preambulë të këtij vendimi të atakuar me këtë ankesë, por kjo nuk nënkupton dhe nuk përjashtohet mundësia që në vazhdim të ndërmerren veprime konformë Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë që mundësojnë që ankuesi të mos gjendet në ndonjë konflikt të interesit për shkak të hetimit penal në ushtrimin e pozitës që e mbanë konformë aktemrimit dhe përmes procedurave të komisionit disiplinor mund të ndërmerren veprimet adekuate ligjore duke u bazuar edhe në këshillat/opinionin ligjor të Departamentit të Menaxhimit të Zyrtarëve Publik(DMZP) në lidhje me këtë çështje, nga se sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë neni 11 paragrafi 1.10,DMZP-ja,ka përgjegjësi ligjore të këshilloj institucionet në zbatim të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Mbi bazën e asaj që u tha më lartë obligohet Kryetari i Komunës së Vitisë që pas pranimit të këtij vendimi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh ta rishqyrtojë Vendimin e datës 17.08.2021 me nr.02-035/02-588 për pezullim sipas detyrës zyrtare.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda,A.nr.779/2021,datë 20.04.2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryetarit të Komunës së Vitisë;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

